



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06-29626/26
Klinë, datë: 10.09.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i katërt publik për Draft-Buxhetin e vitev 2027 - 2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave Zajm, Gremnik, Deiq, Dollc, Jagodë dhe Dresnik të komunës së Klinës, me, datë 31.08.2026, ora 17:00, shkolla fillore "Motrat Qirazi" Zajm.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 07/09/2026 në emailin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i Draft-Buxhetit i vitev 2027-2029 i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft-buxheti edhe në formatin elektronik.

Takimi ka nisur në ora 17:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 20 persona, prej të cilëve, 20 burra.

Shtojca 4 – Fotografi nga dëgjim i katërt për draft-buxhetin e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave: Zajm.Gremnik,Deiq,Dollc,Dresnik,dhe Jagogd te komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:

Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës,

Një përshëndetje e veçantë për banorët e fshatrave Zajm, Deiq, Dollc, Jagod, Gremnik dhe Dresnik, si dhe për të gjithë qytetarët e komunës sonë.

Sot para jush po prezantojmë Draft-Buxhetin e Komunës së Klinës për vitin 2027, një dokument i rëndësishëm që përcakton prioritetet dhe investimet që synojmë t'i realizojmë gjatë vitit të ardhshëm qëllimi ynë është që buxheti të jetë në shërbim të qytetarëve dhe të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së tyre. Vëmendje të veçantë do t'i kushtojmë infrastrukturës, rrugëve, ujësjellësit, kanalizimit, ndriçimit publik, bujqësisë, arsimit dhe përmirësimit të hapësirave publike në veçanti, do të vazhdojmë të investojmë në fshatra dhe në zonat rurale, sepse zhvillimi i Klinës duhet të jetë i barabartë për të gjithë. Ne duam që çdo qytetar, pavarësisht se jeton në qytet apo në fshat, të ketë kushte më të mira për jetë dhe punë gjatë vitit 2027 synojmë të vazhdojmë me projekte që kanë ndikim të drejtpërdrejtë te qytetarët, duke përmirësuar rrugët dhe infrastrukturën, duke krijuar kushte më të mira për të rinjtë dhe duke mbështetur familjet, fermerët dhe bizneset lokale ky draft-buxhet nuk është vetëm një listë shifrash dhe projektesh. Ai është një plan për zhvillimin e komunës sonë dhe për një Klinë më të mire prandaj, ju ftoj të gjithëve të kontribuoni me sugjerimet dhe kërkesat tuaja gjatë procesit të konsultimit publik. Bashkë mund të përcaktojmë më mirë prioritetet dhe të sigurohemi që investimet të shkojnë aty ku nevojiten më së shumti.

Diskutimet e pjesëmarrësve

Blerton Sopaj, Zajmë

Kërkojmë që në rrugën nga parku në fshatin Zajm të bëhet renovimi i asfaltit, pasi janë krijuar rreth 24 prerje nga ndërhyrjet e banorëve gjithashtu, kërkojmë të shqyrtohet mundësia e largimit të disa pengesave të shtrira të vendosura në rrugë, pasi numri i tyre është i madh dhe vështirësojnë qarkullimin.

Pergjigjja e Kryetarit: Faleminderit, Blerton. Ne do ta shtrojmë këtë rrugë gjatë vitit të ardhshëm, në tërësi, duke i dhënë një shtresë të re asfalti. Gjithashtu, do ta sinjalizojmë me shenja rrugore, në mënyrë që të krijojmë kushte më të mira dhe më të sigurta për vozitësit dhe banorët e fshatit Zajm.

Metë Krasniqi,Zajmë

Kërkesa ime është: 100 metra kanalizim në lagjen Sopaj.

Pergjigja e Kryetarit: Kërkesën tuaj e pranojmë dhe do ta evidentojmë në procesverbal. Komisioni, të cilin e kam themeluar, do ta përfshijë këtë kërkesë në raport, i cili më pas do të procedohet në Kuvendin Komunal të Klinës synimi është që kjo kërkesë të përfshihet në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm, 2027

Dalip Gashi,Zajmë

Kërkesa ime është: jemi katër shtëpi në fshatin Zajm që nuk kemi kanalizim. A ka mundësi të na ndihmoni.

Pergjigja e Kryetarit: Faleminderit, Dalip unë personalisht do të dal në teren për ta parë nga afër gjendjen kërkesën tuaj do ta marrim me prioritet dhe do ta përfshijmë në Draft-Buxhetin për vitin 2027, me qëllim që ta rregullojmë kanalizimin.

Tun Dedaj,Deiq

Përshëndetje, Kryetar. Përshëndetje të gjithëve.

Kam dy kërkesa të banorëve: një për fshatin Zajm dhe një për fshatin Deiq. Kërkoj që të shqyrtohet mundësia për ndërtimin e nga një këndi lojërash për fëmijë në të dyja fshatrat. Gjithashtu, kërkoj zgjerimin e një kanali të ujit. Faleminderit!

Pergjigjja e Kryetarit: Faleminderit, Tun. Kërkesat tuaja do t'i paraqesim në raport dhe do t'i përfshijmë në projektet e vitit të ardhshëm, me qëllim që t'i realizojmë dhe përfundojmë.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 17:40

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	20
Totali	20

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu

